

VENDIM
Nr. 703, datë 4.11.2022

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 19, DATË 16.1.2019, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË
PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË
PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT ‘PËR RIKUALIFIKIMIN URBAN DHE
ZHVILLIMIN E BLOKUT NR. 2, QENDRA E QYTETIT ROSKOVEC’, TË
NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 19, datë 16.1.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 3, vlera e përgjithshme e shpronësimit prej “... 30 755 074 (tridhjetë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekësh...”, zëvendësohet me vlerën “... 26 117 513.4 (njëzet e gjashtë milionë e njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind e trembëdhjetë pikë katër) lekësh...”.

2. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, për pasuritë e llojit “truall” dhe “ndërtesë”, me vlerë 26 117 513.4 (njëzet e gjashtë milionë e njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind e trembëdhjetë pikë katër) lekë, përballohet, si më poshtë vijon:

a) 24 435 412 (njëzet e katër milionë e katërqind e tridhjetë e pesë mijë e katërqind e dymbëdhjetë) lekë, nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë;

b) 1 682 101.4 (një milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e njëqind e një pikë katër) lekë, nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.”.

3. Pasuritë me nr. 2/170+1-3, nr. 2/170+1-2, nr. 2/170-N1, nr. 2/170+1-1, që përkojnë me numrat rendorë 10, 12, 13 dhe 15, hiqen nga tabela e shpronësimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Të dhënat e numrit rendor 14, për pasurinë 2/170, ZK 3196, në tabelën bashkëlidhur vendimit, zëvendësohen me të dhënat në tabelën, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

II. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Bashkia Roskovec.

III. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bashkia Roskovec dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE QË PREKET NGA DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 19, DATË 16.1.2019, PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “PËR RIKUALIFIKIMIN URBAN DHE ZHVILLIMIN E BLOKUT NR. 2, QENDRA E QYTETIT ROSKOVEC”, I NDRYSHUAR

Nr.	Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K	Nr. i pas.	Shënime
-----	-----	------	--------	---------	-----	------------	---------

	rendor në VKM nr. 705/201 9						Sipërfaqja truall (m ²)	Çmimi lekë (m ²)	Vlera (lekë)	
1	14	Mareglën	Avdul	Hazizi	3196	2/170	61,6 m ²	494	30, 430.4	Konfirmuar nga ASHK-ja Roskovec
Vlera totale									30, 430.4	

Shënime

Sipas shkresës nr. 5202 prot., datë 7.10.2020, të Bashkisë Roskovec, rezulton të ketë ndryshuar projekti për “Rikualifikimin urban i bllokut nr. 2 qendra e qytetit Roskovec”, dhe si rrjedhojë pasuritë nr. 2/170+1-3, nr. 2/170+1-2, nr. 2/170-N1, nr. 2/170+1-1, që përkojnë me numrat rendor 10, 12, 13, dhe 15, të tabelës së shpronësimit, bashkëlidhur vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 19, datë 16.1.2019, nuk preken nga ndryshimet e këtij projekti, dhe pronarët nuk shpronësohen, rrjedhimisht këto pasuri hiqen nga tabela e shpronësimit. Gjithashtu, korrigjohet sipërfaqja e pasurisë 2/170, e cila përkon në numër rendor 14 të tabelës bashkëlidhur VKM nr. 19, datë 16.1.2019, nga 103 m² bëhet në 61.6 m², ndodhur në zonën kadastrale 3196. Pasuritë, të cilat hiqen nga tabela e VKM nr. 19, datë 16.1.2019, referuar shkresës së Bashkisë Roskovec nr. 8198/1, datë 16.12.2021 nuk janë likuiduar.